



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.10.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 12.10.2023, të diplomuar në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar 2020-2023”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:31 dhe mbaroi në orën 14:39.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |

10. Yllka Rupa

(anëtare)

Shënim 1: Nuk merr pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

3. Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).

5. Arturo Valdes dhe Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE (në sallë).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

7. BIRN, si dhe përfaqësues të tjerë nga mediat.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 12.10.2023, të diplomuar në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar 2020-2023”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Përshëndetje të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për shkak të një angazhimi pranë Kuvendit të Shqipërisë të Kryetares, *znj. Llagami*, mbledhjen e sotme do e drejtoj unë, Zëvendëskryetari Ilir Rusi.

Sipas rendit të ditës, fillojmë me pikën e parë të tij që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 12.10.2023, të diplomuar në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar 2020-2023”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Atëherë, ne kemi përgatitur relacionin dhe bashkë me relacionin, projektvendimin “Për shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 12.10.2023, të diplomuar në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar 2020-2023 në Shkollën e Magjistraturës”.

Relacioni përmban analizën dhe tabelat përkatëse në lidhje me pasqyrimin e sistemit të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit në lidhje me vendet, vakancat e përhershme, vakancat e përkohshme, mungesat në detyrë, lejet, komandimet, pra gjithçka janë të parashikuara dhe të pasqyruara në tabelat që janë integruar në pjesë të relacionit. Dhe në bazë të analizave që ne kemi bërë si Komision, kemi arritur në konkluzionet e mëposhtme të cilat lidhen me propozimin që bëjmë ne për shpalljen e vendeve të lira si vakanca të përhershme në gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm, por edhe në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Lushnjë. Më konkretisht propozojmë për pozicionet e lira si më poshtë:

i) dy pozicione të lira në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat;

ii) katër pozicione të lira në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër;

iii) tre pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;

iv) gjashtë pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;

v) dy pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë;

vi) katër pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;

vii) një pozicion në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës;

viii) gjashtë pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë;

ix) tre pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë;

x) tre pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;

xi) katër pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë;

xii) dy pozicione në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

Në përfundim, duke bërë edhe llogaritjen e pozicioneve të shpallura me kandidatët të cilët janë emëruar si magjistratë, rezulton që të 40 magjistratët të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe të emëruar si magjistratë me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor i pozicionojmë në pozicionet e tyre të përhershme në vendet e paraqitura nga Komisioni si pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.

Me pak fjalë, ky ishte prezantimi në lidhje me pozicionet.

Pas shpalljes dhe marrjes së vendimit për shpalljen e pozicioneve, normalisht këto pozicione duhet t'i bëhen të ditura magjistratëve, që ata në fund fare të japin preferencat e tyre. Duke marrë shkas edhe nga situata në të cilën ndodhemi, ku nuk jemi në afatin e duhur kohor për t'i caktuar sipas ligjit "Për statusin" në pozicion magjistratët, ne propozojmë që afati të jetë sa i arsyeshëm, aq edhe i nevojshëm si për vendimmarrjen e mëtejshme të Këshillit por edhe për ushtrimin e funksioneve magjistratëve të rinj. Kështu që në pikën 5 të projektvendimit ne do propozonim, nëse edhe kolegët bien dakord, ditën e nesërme, pra 24 orë kohë, si mundësi, si kohë e nevojshme që magjistratët e emëruar do sjellin preferencat e tyre në lidhje me pozicionet e shpallura si të lira nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Pra sot është data 18, 19, në orën 12:00, që të na japi edhe neve mundësi më pas që pas marrjes së preferencave të përgatisim relacionin e radhës për caktimin në pozicion të kandidatëve, duke menduar që të procedojmë edhe ne shpejt për t'i mbyllur sa më shpejt të gjitha procedurat në lidhje me caktimin e tyre në pozicion dhe pastaj të vazhdojmë me betimin e tyre.

Pra propozimi vetëm për pjesën e afatit është 24 orë kohë. Pozicionet janë ato që unë i prezantova. Këto kishim. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua në lidhje me pozicionet (gjykatën përkatëse) dhe me afatin e aplikimit?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, të vazhdohet me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 12.10.2023, të diplomuar në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar 2020-2023”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Shpalljen e pozicioneve të lira për të diplomuarit në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2022-2023 dhe të emëruar gjyqtarë më datë 12.10.2023.

2. Pozicionet e lira janë si më poshtë:

i) dy pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat;

ii) katër pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër;

iii) tre pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;

iv) gjashtë pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;

v) dy pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë;

vi) katër pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;

vii) një pozicion në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës;

viii) gjashtë pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë;

ix) tre pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë;

x) tre pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;

xi) katër pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë;

xii) dy pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Lushnjë.

3. Të emëruarit sipas pikës 1 të këtij vendimi kanë të drejtë të përcaktojnë, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata nga ato sipas pikës 2 të këtij vendimi, në të cilat ata kërkojnë të caktohen.

4. Të emëruarit sipas pikës 1 të këtij vendimi kanë detyrimin të deklarojnë situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të nenit 8, pika 3, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

5. Afati i aplikimit është deri më datë 19.10.2023, ora 12.00. Mungesa e aplikimit nuk passjell ndalimin e procedurës së caktimit në pozicion të të emëruarve.

6. Në momentin e aplikimit të emëruarit sipas pikës 1 të këtij vendimi duhet të dorëzojnë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor këto dokumente:

i) Një deklaratë me shkrim ku përcakton, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata nga ato sipas pikës 2 të këtij vendimi, në të cilat kërkon të caktohet.

ii) Një vetëdeklarim me shkrim, sipas Shtojcës së këtij vendimi, ku të deklarojë nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të nenit 8, pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.10.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, znj. {...}” (relatore znj. Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:31 dhe mbaroi në orën 14:39.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk merr pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.

2. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

3. Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).

5. Arturo Valdes dhe Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE (në sallë).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

7. BIRN, si dhe përfaqësues të tjerë nga mediat.

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, znj. {...}” (relatore znj. Marçela Shehu).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën dy të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, znj. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni, me relatore znj. Marçela Shehu. Për më tej fjalën zonja Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar.

Sikurse e cituat, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka paraqitur për shqyrtim mbledhjes plenare projektvendimin për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, znj. {...}.

Sikurse jeni në dijeni, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 516 datë 05.10.2023 ka vendosur:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

- 1) Znj. {...};
- 2) Z. {...};
- 3) Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve të cilët kishin edhe të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit.

Më datë 05.10.2023, në rrugë elektronike, kandidates znj. {...}, iu njoftua vendimi i Këshillit si më sipër dhe referuar deklaratës së kandidates të dërguar po në rrugë elektronike, protokolluar në Këshill me aktin nr. {...}, datë 05.10.2023, është shprehur se pasi u njoh me vendimin e Këshillit, deklaroi se nuk ka ankim ndaj tij.

Më datë 05.10.2023, në rrugë elektronike, kandidates znj. {...}, iu njoftua vendimi i Këshillit si më sipër dhe referuar deklaratës së kandidates të dërguar po në rrugë elektronike, protokolluar në Këshill me aktin nr. {...}, datë 05.10.2023, është shprehur se pasi u njoh me vendimin e Këshillit, deklaroi se nuk ka ankim ndaj tij.

Më datë 05.10.2023, në rrugë elektronike, kandidatit Z. {...}, iu njoftua vendimi i Këshillit si më sipër dhe referuar deklaratës së kandidatit të dërguar po në rrugë elektronike, protokolluar në Këshill me aktin nr. {...}, datë 09.10.2023, është shprehur se u njoh me vendimin e Këshillit.

Gjithashtu, më datë 05.10.2023, në rrugë elektronike, kandidatit z. {...}, iu njoftua vendimi i Këshillit dhe referuar deklaratës së kandidatit të dërguar në Këshill me aktin nr. {...}, datë 06.10.2023, është shprehur se pasi u njoh me vendimin e Këshillit, deklaroi se nuk ka ankim ndaj tij.

Në vijim, në rrugë elektronike më datë 12.10.2023, u kërkua nga Gjykata Administrative e Apelit informacion lidhur me faktin nëse ndaj vendimit të mësipërm nr. 516, datë 05.10.2023 të Këshillit është ushtruar apo jo ankim nga kandidatët në procedurën e përzgjedhjes.

Po në rrugë elektronike, më datë 12.10.2023, nga Gjykata Administrative e Apelit u konfirmua se nuk është ushtruar ankim nga kandidatët e mësipërm ndaj vendimit të Këshillit nr. 516, datë 05.10.2023.

Sa sipër, kandidatja znj. {...} rezulton të jetë kandidat fitues, në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 185, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe duke vlerësuar se vendimi i Këshillit për miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurat e ngritjes në detyrë, është një vendim i formës së prerë, në zbatim të pikës 68, të vendimit 70/2020, me cilësinë e relatores kam përgatitur projektvendimin për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të gjyqtarës znj. {...}, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 185, datë 28.05.2020.

Projektvendimi i propozuar titullohet “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, znj. {...}”.

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika.

Pika 1 e projektvendimit bën fjalë për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, znj. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se efektet juridike të tij fillojnë më datë, që nuk është përcaktuar nga ana jonë por që mbetet të përcaktohet nga Këshilli dhe në momentin e shqyrtimit të këtij projektvendimi. Në lidhje me përcaktimin e efekteve juridike do ju sillja në vëmendje atë çka parashtruar Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i cili ndër të tjera parashtron se:

“Sikurse jeni në dijeni, magjistratja znj. {...} është e vetmja magjistrate e profilit gjyqtar e komanduar si inspektore pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nga krijimi i ILD-së, deri aktualisht. Me gjithë thirrjet e hapura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për komandim nga radhët e gjyqtarëve, përfshirë edhe thirrjen e fundit, ende nuk ka asnjë kandidat gjyqtar për pozicionin inspektor.

Ndërkohë, inspektorja magjistrate {...} ka në proces një numër të konsiderueshëm praktikash, disa edhe në fazë hetimi, të cilat për nga natyra e tyre janë edhe sensitive dhe do duhej të përfundonin nga e njëjta inspektore, kjo edhe për shkak të përvojës dhe profilit të saj.

Në këto kushte, duke krijuar një balancë midis nevojave të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për gjyqtarë të emëruar pranë saj, si dhe nevojave të institucionit të ILD-së, të cituara më lart, ILD i kërkon Këshillit të Lartë Gjyqësor të shohë mundësinë e shtyrjes së efekteve të vendimit të emërimit të inspektores {...} në fillim të vitit kalendarik 2024.”

Ky është e-maili, pra ajo çka parashtron Inspektori i Lartë i Drejtësisë në e-mail-in e dërguar.

Ndërsa në pikën tre të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016.

Ky është projektvendimi i përgatitur nga ana jonë, nga KZHK-ja, ku mbetet për t’u diskutuar në Këshill përcaktimi i pikës 2 në lidhje me efektet juridike të këtij vendimi.

Ilir Rusi: Ju si relatore, keni ndonjë propozim mbi të cilin të diskutojë Këshilli?

Marçela Shehu: Në cilësinë e relatores mendoj që nga Këshilli duhet të konsiderohet shqetësimi i ngritur nga zoti Inspektor i Lartë i Drejtësisë në atë çka ai ka parashtruar, pra duhet të konsiderohet fakti që zonja {...} është e vetmja magjistrate e profilit gjyqtar që aktualisht është në detyrën e inspektores pranë ILD-së, kështu që mendoj për t’i dhënë një kohë edhe inspektores për të përmbyllur dosjet që ajo ka në ngarkim, t’i linim një afat të mjaftueshëm, por sigurisht pa cenuar nevojat që ka gjykata e apelit. Inspektori në fakt ka kërkuar fillimin e vitit kalendarik, unë do të propozoja 1 dhjetorin 2023, nëse kolegët do të ishin dakord.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Po, zoti Toro!

Alban Toro: Më lejoni të theksoj që apeli Tiranë, e kam thënë prej kohësh, vijoj ta them, që përveç problemit të thellë që ka me infrastrukturën, ka një problem goxha të akumuluar me çështjet të cilat ajo ka në gjykim, që synojnë të sensibilizojnë me peshën e vet specifike por që fatkeqësisht ne nuk na kanë sensibilizuar sepse nuk kemi reagu

12

siç kemi reaguar për gjykata të cilat kanë pasur një performancë të dobët, gjithsesi kemi krijuar instrumenta të tillë që t'i ndihmojmë këto gjykata.

Atëherë, shkresa më e freskët dhe më e fundit që vjen nga titullarja e këtij institucioni daton më 12.10.2023 ku titullarja fokusohet tek akumulimi i çështjeve të tilla që është 37.000 (ndërpret mendimin)...Tani, standardet i di më mirë se ty Brikena dhe i njoh më mirë dhe i respektoj më mirë, por e lëmë, se ka faktorë të tjerë për atë letërshkruesin e parë. Në rastin konkret po flas për titullaren e cila përmend dhe citon 37.000 çështje të administruara, të cilat nuk po bëhet fjalë për respektim të parimit “Drejtësi e vonuar, drejtësi e mohuar”, sepse ata tashmë e kanë shkelur këtë parim, për shkaqe objektive natyrisht sepse ka një trupë prej 20 e ca gjyqtarësh dhe llogarisni vetë peshën specifike (ka 2000 çështje civile, ka 1300 çështje penale të administruara), pra një peshë v rastare për trupën gjyqësore dhe ajo që ne po bëjmë është që edhe në momentin kur kemi një konkurrim dhe finalizohet minimalisht me transferimin apo me ngritjen në detyrë të këtyre personave të cilët kanë konkurruar (magjistratëve), tentojmë që t'i japim kohë institucioneve të tjera që të asimilojnë peshën që ata kanë. Ndërkohë që, në peshën e dhimbshme të gjyqësorit, kjo peshë vazhdon të mbajiset apo të bëhet akoma më keq duke rënduar natyrisht mbi publikun. Kështu që, mendoj që, koha është shumë e gjatë, ndërkohë që këta gjyqtarë që kanë konkurruar dhe kanë fituar duhet të ishin në punë dje, meqenëse s'janë dje, të paktën t'i çojmë më 1 nëntor, për të gjetur një të mesme, në mënyrë që të kompozojnë trupa gjyqësore të tilla që të absorbojnë një pjesë të peshës (natyrisht që edhe kjo është e pamundur për të absorbuar 37.000 të tilla për një kohë të shkurtër), por do të na duhet përsëri të mendojmë që t'u japim mundësi që t'u japim edhe instrumenta të tjerë ndihmës, siç u kemi dhënë gjykatave ku letërshkruesit kanë kërkuar dhe u kemi dhënë instrumenta, por që performancën e kanë pasur të dobët. Kështu që në këtë kontekst mendoj që afati maksimal për të mbaruar dosjet sensible të shpejta, të jetë 1 nëntori dhe pas kësaj date të mundohemi të kompozojmë sa më shumë trupa gjyqësor pranë kësaj gjykate. Faleminderit!

Ilir Rusi: Po, zoti Hado!

Ridvan Hado: Edhe unë duke qenë dakord me z. Alban, për të mos rënë në përsëritje, që të gjitha ato pretendime që ngriti janë të qëndrueshme. Për ekuilibër pra jam dakord me datën 1 nëntor, duke qenë se edhe gjykata e apelit Tiranë është me shumë ngarkesë, në mungesë të trupës gjyqësore (nga 78 ka vetëm 22 gjyqtarë). Ndërkohë, për të gjetur ekuilibrin bashkë me kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, edhe unë jam dakord për datën 1 nëntor që të fillojnë të dy gjyqtarët.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Po, zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Unë i dëgjova propozimet e kolegëve të mi dhe secili nga kolegët shfaqti problematikën që ekziston si në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ku ne jemi njohur tashmë edhe me ngarkesën e punës, por nga ana tjetër, dëgjova me vëmendje edhe propozimin që bëri zonja Shehu në këtë rast, e cila evidentoi edhe ngarkesën e punës që ka ILD-ja vetë si institucion, si dhe faktin tjetër që ekziston vetëm një magjistratë aktualisht nga radhët e gjyqësorit që punon si inspektore pranë ILD-së. Pra të dyja situatat nuk janë situata të qëndrueshme, të qeta, ku ne mund të themi që mund të marrim një vendim të saktë dhe pa dëmtuar si njërin institucion ashtu edhe institucionin tjetër. Ndodhur në këto situata është e vërtetë që ndoshta ai propozimi i bërë nga zonja Shehu, deri në 1 dhjetor (mendimi im), mund të jetë ndër propozimet e para, duke iu referuar rrethanave në lidhje me kohëzgjatjen e fillimit të detyrës disi jo i natyrshëm referuar praktikës që kemi ndjekur neve si Këshill, por edhe nga ana tjetër këto situata unë nuk mund të mos i marr në vlerësim, sepse siç e thashë, ajo është e vetmja magjistrate punon në cilësinë e inspektore pranë ILD-së.

Ndodhur në këto kushte, duke marrë në konsideratë të gjitha këto rrethana, unë kam një propozim tjetër, po themi më të moderuar, duke iu referuar edhe propozimeve që mbajtën kolegët e mi. Kështu që unë do propozoja një 30 ditësh, pra nga momenti i sotëm, 30 ditë si afat përfundimtar, brenda të cilit inspektorja në këtë rast mund të mbylli të gjitha detyrimet e veta të ngutshme, sepse këto detyrime duhet të jenë të ngutshme

dhe afati 30-ditor për mendimin tim është afat i arsyeshëm dhe gjatë kësaj kohe besoj se do merren masat nga ajo vetë personalisht, por edhe nga gjykata, për t'i krijuar mundësitë dhe kushtet e saj për të ushtruar funksionin më tej si gjyqtare në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Pra unë mendoj se një 30 ditësh besoj se do jetë një afat i arsyeshëm. Faleminderit!

Ilir Rusi: Ju falënderoj, edhe për propozimet e efekteve juridike se kur do fillojnë, së bashku me argumentet.

Fillimisht po hedhim në votim propozimin e relatores zonjës Shehu që ky akt t'i fillojë efektet juridike më datë 1 dhjetor të vitit 2023.

Irena Plaku: Unë jam dakord për propozimin për 1 dhjetor, pasur parasysh që të kemi një balancë ndërmjet ngarkesës në punë që ka pranë ILD-së që është institucion i drejtësisë ndër të tjera dhe është e vetmja inspektore që është gjyqtare atje, kështu që duhet të kemi edhe përfaqësimin pranë ILD-së. 1 dhjetori për mua është shumë dakord në balancë edhe me Gjykatën e Apelit.

Dritan Hallunaj: Atëherë, edhe unë jam pro propozimit dhe arsyeja është, për të mos iu kthyer edhe një herë diskutimeve, arsyeja është që me të vërtetë kemi situatën tek Gjykata e Apelit në atë gjendje që është, por nuk është se do ndryshojë gjë prania apo jo e një gjyqtari, ndërkohë kur kjo është e vetme tek pjesa e ILD-së, dhe do thosha që të ishte edhe më tej, pra të pranohej më tej se 1 dhjetori, por meqenëse ky është propozimi, unë jam dakord me propozimin. Faleminderit!

Ridvan Hado: Kundër, me argumentet që tha zoti Toro dhe unë gjithashtu. Faleminderit!

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Pro propozimit.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro propozimit.

Brikena Ukperaj: Pro propozimit të relatores.

Klodian Kurushi: Unë jam me atë propozimin që bëra më lart. Kështu që jam kundër këtij propozimi. Më vjen keq.

Ilir Rusi: Dakord me propozimin.
Do të thotë që efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 1 dhjetor të vitit 2023.

Hedhim në votim projektvendimin.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Pro, me rezervën që thashë.

Alban Toro: Pjesërisht dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Duke u plotësuar akti edhe se kur i fillon efektet juridike, atëherë vendim “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, znj. {...}.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 01.12.2023.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.10.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e afatit të komandimit si inspektore në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për magjistraten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:31 dhe mbaroi në orën 14:39.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |

18

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 18.10.2023 (Pika 3)***

Shënim 1: Nuk merr pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

3. Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).

5. Arturo Valdes dhe Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE (në sallë).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

7. BIRN, si dhe përfaqësues të tjerë nga mediat.

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e afatit të komandimit si inspektore në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për magjistraten *znj. {...}*”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore *znj. Marçela Shehu*).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën tre të rendit të ditës, shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e afatit të komandimit si inspektore në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për magjistraten *znj. {...}*”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatores, zonjës Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur për shqyrtim dhe miratim mbledhjes plenare gjithashtu projektvendimin “Për përfundimin e afatit të komandimit si inspektore në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për magjistraten *znj. {...}*”.

Me vendimin nr. {...}, datë 05.07.2013, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë magjistratja znj. {...} është emëruar në detyrën e inspektore pranë Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në vijim, me vendimin nr. {...}, datë 29.06.2018 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i është zgjatur mandati i inspektorit deri në krijimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ndërkohë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në kuadër të vlerësimit të statusit individual për inspektorët e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, lidhur me inspektoren {...}, me vendimin nr. 217, datë 22.10.2019 ka vendosur: Të deklarojë pasjen e statusit të magjistratit për zonjën {...}. Zonja {...} të vijojë komandimin në detyrën e nëpunësit në njësinë e vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve pranë KLGJ-së.

Në vijim, pas kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 69, datë 07.02.2020 ka vendosur:

1. Komandimin e përkohshëm si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të magjistrates znj. {...}, për një periudhë 6-mujore.

Po me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe me pëlqimin e magjistrates së komanduar përkohësisht znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 333, datë 17.09.2020 ka vendosur:

1. Zgjatjen e afatit të komandimit të përkohshëm si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të magjistrates znj. {...}, deri në përfundim të procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë ku ajo ka kandiduar.

Ndërkohë, më herët, gjyqtarja znj. {...} ka kandiduar në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Aktualisht, ka përfunduar procedura e ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 185, datë 28.05.2020 dhe i është paraqitur për miratim Këshillit të Lartë Gjyqësor projektvendimi “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, znj. {...}”, projektvendim i cili sapo u miratua nga ky Këshill.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur dhe paraqitur për shqyrtim projektvendimin “Për përfundimin e afatit të komandimit si inspektore në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të magjistrates znj. {...}”.

Për këtë, Komisioni ka në vëmendje përcaktimin e kërkesave të nenit 57 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar lidhur me Përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit.

Projektvendimi është ai që ju është paraqitur.

Në pikën 1 të tij përcaktohet përfundimi i afatit të komandimit si inspektore në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për gjyqtaren znj. {...}, duke shtuar “më datë 30.11.2023”, duke qenë se Këshilli vendosi që efektet juridike të vendimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të kandidatës të ishim në datë 1 dhjetor 2023.

Në pikën 2 të projektvendimit parashikohet që ky vendim i njoftohet znj. {...}.

Në pikën 3 e drejta e ankimit kundër këtij vendimi.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e afatit të komandimit si inspektore në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për magistraten znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Përfundimin e afatit të komandimit si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të magjistrates znj. {...}, më datë 30.11.2023.

2. Një kopje e vendimit i njoftohet magjistrates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.10.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, z. {...}” (relatore znj. Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:31 dhe mbaroi në orën 14:39.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

23

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 18.10.2023 (Pika 4)***

Shënim 1: Nuk merr pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.

2. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

3. Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).

5. Arturo Valdes dhe Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE (në sallë).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

7. BIRN, si dhe përfaqësues të tjerë nga mediat.

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, z. {...}” (relatore znj. Marçela Shehu).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën katër të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, z. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatores zonjës Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka paraqitur për shqyrtim mbledhjes plenare projektvendimin “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, z. {...}”.

Sikurse jeni në dijeni, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin e tij nr. 515, datë 05.10.2023 ka vendosur:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 184, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

- 1) Z. {...};
- 2) Z. {...}.

2. Një kopje e vendimit i njoftohet kandidatëve të cilët kishin të drejtën e ankimit.

Më datë 05.10.2023, në rrugë elektronike, kandidatit zotit {...}, iu njoftua vendimi i Këshillit si më sipër dhe referuar deklaratës së kandidatit të dërguar po në rrugë elektronike më datë 06.10.2023, protokolluar në Këshill me aktin nr. 5146, datë 06.10.2023, është shprehur se pasi u njoh me vendimin e Këshillit, deklaroi se nuk ka ankim ndaj tij.

Më datë 05.10.2023, në rrugë elektronike, kandidatit zotit {...}, iu njoftua vendimi i Këshillit si më sipër dhe referuar deklaratës së kandidatit të dërguar po në rrugë elektronike më datë 05.10.2023, protokolluar në Këshill me aktin nr. {...}, datë 09.10.2023, është shprehur se u njoh me vendimin e Këshillit.

Në vijim, në rrugë elektronike me datë 12.10.2023, u kërkua nga Gjykata Administrative e Apelit informacion lidhur me faktin nëse ndaj vendimit të mësipërm nr. 515, datë 05.10.2023 të Këshillit është ushtruar ankim nga kandidatët në procedurën e përzgjedhjes.

Po në rrugë elektronike, më datë 12.10.2023, nga Gjykata Administrative e Apelit u konfirmua se nuk është ushtruar ankim nga kandidatët e mësipërm ndaj vendimit të Këshillit nr. 515, datë 05.10.2023.

Sa sipër, kandidati z. {...} rezulton të jetë kandidat fitues, në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 184, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe duke vlerësuar se vendimi i Këshillit për miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurat e ngritjes në detyrë, është një vendim i formës së prerë, në zbatim të pikës 68, të vendimit 70/2020, me cilësinë e relatores kam përgatitur projektvendimin për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të

Përgjithshëm Tiranë, të gjyqtarit z. {...}, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 184, datë 28.05.2020.

Projektvendimi i propozuar titullohet “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, z. {...}”. Është i strukturuar në 3 pika.

Pika 1 bën fjalë për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, z. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se efektet juridike të tij fillojnë në datën që nuk është përcaktuar nga ana jonë sepse është vlerësuar që ky moment duhet të përcaktohet nga Këshilli në momentin e shqyrtimit të projektvendimit nga Këshilli.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} si dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Dhe në fund përcaktohet hyrja në fuqi e projekt-aktit.

Lidhur me përcaktimin e efekteve juridike të vendimit unë do doja t’ju sillja në vëmendje ngarkesën e punës aktuale të deklaruar nga vetë zoti {...}, kërkuar nga ana ime si relatore.

Në përgjigje të kërkesës që është parashtruar, zoti {...} citon: “Në cilësinë e gjyqtarit të komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kam hartuar projektraporte profesionale për subjektet e rivlerësimit, gjyqtarë dhe ndihmës ligjorë, duke ushtruar detyrën e nëpunësit përgjegjës pranë Komisionit të Përkohshëm si dhe kam qenë dhe jam përfaqësues i KLGJ-së në procese të ndryshme gjyqësore ku kjo e fundit ka qenë palë ndërgjyqëse. Në cilësinë e nëpunësit përgjegjës pranë Komisionit të Përkohshëm kam ende në shqyrtim 4 subjekte, që janë: {...}, ish-inspektore e KLD-së; {...}, ish-ndihmëse ligjore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, aktualisht emëruar gjyqtare pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës; {...}, anëtare e KPA-së dhe {...}, ish-ndihmës ligjor në Gjykatën e Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, aktualisht ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë. Për këto katër subjekte të sipërcituara, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ende nuk ka disponuar me zhvillimin e procedurave të shortit për përzgjedhjen e pesë dosjeve, me qëllim hartimin e projektraporteve të rivlerësimit

profesional të tyre. Gjithashtu kam në ndjekje edhe disa procese gjyqësore ku jam si përfaqësues i KLGJ-së pranë disa gjykatave të ndryshme.”

Ky është informacioni i vetëdeklaruar nga zoti {...}, që vlerësoj se duhet të konsiderohet nga Këshilli në lidhje me përcaktimin e efekteve juridike të projektvendimit për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të gjykatës së apelit.

Bazuar në sa më sipër, unë do të propozoja që efektet juridike të këtij vendimi për zotin {...} të mos ishin ato që ne parashikuam për zonjën {...}, pra mendoj që efektet juridike të jenë më të shpejta në kohë, duke propozuar datën 1 nëntor 2023.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord. *(Vota e zotit Toro nuk dëgjohet në audio, por i kontaktuar nëpërmjet e-mailit, ndër të tjera, ka konfirmuar votën “dakord”. Për efekt të procesverbalit e-maili i konfirmimit të votës i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.)*

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, z. {...}.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 01.11.2023.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar si dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.10.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e afatit të komandimit si nëpunës përgjegjës në njësinë e vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, të magjistratit z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:31 dhe mbaroi në orën 14:39.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
- 2. Klodian Kurushi** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli** (anëtare)
- 4. Irena Plaku** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 6. Ridvan Hado** (anëtar)
- 7. Alban Toro** (anëtar)
- 8. Marçela Shehu** (anëtare)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtare)

10. Yllka Rupa

(anëtare)

Shënim 1: Nuk merr pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

3. Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).

5. Arturo Valdes dhe Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE (në sallë).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

7. BIRN, si dhe përfaqësues të tjerë nga mediat.

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e afatit të komandimit si nëpunës përgjegjës në njësinë e vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, të magjistratit z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e afatit të komandimit si nëpunës përgjegjës në njësinë e vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, të magjistratit z. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatores zonjës Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit z. Zëvendëskryetar!

Në vijim të miratimit të projektvendimit për ngritjen në detyrë të gjyqtarit z. {...}, është përgatitur gjithashtu nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës projektvendimi “Për përfundimin e afatit të komandimit si nëpunës përgjegjës në njësinë e vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, të magjistratit z. {...}”, duke parashtruar si më poshtë:

Me vendimin nr. 219, datë 17.12.2007, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, magjistrati z. {...} është emëruar inspektor pranë Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Pas përfundimit të mandatit të parë si inspektor, me vendimin nr. {...}, datë 20.12.2012 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, magjistrati z. {...} është riemëruar inspektor pranë Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në vijim, me vendimin nr. {...}, datë 24.01.2018 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, magjistratit z. {...} i është zgjatur mandati deri në krijimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ndërkohë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në kuadër të vlerësimit të statusit individual për inspektorët e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, lidhur me inspektorin {...}, me vendimin nr. 218, datë 22.10.2019 ka vendosur:

1. Të deklarojë pasjen e statusit “Magjistrat” për z. {...}.
2. Zoti {...} të vijojë komandimin në detyrën e nëpunësit përgjegjës në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor deri në një vendimmarrje tjetër të Këshillit Lartë Gjyqësor.

Ndërkohë, më herët, magjistrati {...} ka kandiduar në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Aktualisht, ka përfunduar procedura e ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 184, datë 28.05.2020 i cili u paraqit për miratim dhe sapo u miratua nga Këshilli i Lartë Gjyqësor “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, z. {...}”.

Në këto kushte, nga Komisioni është përgatitur dhe paraqitur për shqyrtim edhe projektvendimi për përfundimin e afatit të komandimit të z. {...}.

Për këtë, Komisioni ka në vëmendje përcaktimin e kërkesave të nenit 57 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar lidhur me përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit.

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika.

Në pikën 1 parashikohet përfundimi i afatit të komandimit të z. {...} më datë 31.10.2023, në kushtet kur Këshilli vendosi që efektet juridike të vendimit për ngritjen e tij në detyrë të fillojnë më datë 01.11.2023.

Në pikën 2 të projektvendimit parashikohet që një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet z. {...}.

Dhe në pikën 3 parashikohet e drejta e ankimit kundër këtij vendimi.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e afatit të komandimit si nëpunës përgjegjës në njësinë e vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, të magjistratit z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Përfundimin e afatit të komandimit në detyrën e nëpunësit përgjegjës në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, të magjistratit z. {...}, më datë 31.10.2023.

2. Një kopje e vendimit i njoftohet magjistratit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.10.2023)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj):

6.1 “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 15, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

6.2 “Për transferimin e gjyqtarës znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:31 dhe mbaroi në orën 14:39.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |

7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim 1: Nuk merr pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashë.*
2. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
3. *Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
4. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).*
5. *Arturo Valdes dhe Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE (në sallë).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
7. *BIRN, si dhe përfaqësues të tjerë nga mediat.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj):

6.1 “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 15, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

6.2 “Për transferimin e gjyqtarës znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës

në lidhje me renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 15, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për më tej fjalën relatorit z. Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Faleminderit!

Me disa vendimet e datës 18.01.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka hapur procedurën për katërmbëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 15, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, duke përcaktuar edhe afatin kohor.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 15 datë 18.01.2023, kanë kandiduar gjithsej 6 (gjashtë) kandidatë, sipas emrave të mëposhtëm: {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për tre procedura në proces, propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr.77, datë 13.02.2023, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë janë përfshirë 2 (dy) kandidatë sipas vendimit respektiv: {...}, {...}.

Në vijim, me vendimin nr. 115, datë 13.03.2023, Këshilli ka vendosur: “I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet përkatëse të datës 18.01.2023 duke caktuar edhe relatorin për secilin kandidat.

Në vijim z. {...} është tërhequr nga kandidimi për këtë pozicion të lirë, dhe Këshillit me vendimin nr. 383, datë 17.07.2023 ka vendosur: “Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 15, datë

18.01.2023, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion...”.

Gjithashtu edhe kandidatja tjetër znj. {...} është tërhequr nga kandidimi duke passjellë edhe vendimmarrjen e Këshillit me vendimin nr. 384, datë 17.07.2023 e cila ka përfunduar procedurën e lëvizjes paralele për në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për këtë pozicion.

Në vijim ndjekjes së procedurave për lëvizjen paralele për këtë pozicion të lirë kandidatët z, {...} dhe znj. {...} kandidatë që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim, referuar vendimin nr.77, datë 13.02.2023, u tërhoqën nga kandidimi i tyre për këtë pozicion të lirë. Për këta kandidatë Këshilli nuk ka marrë asnjë vendimmarrje lidhur me tërheqjen e tyre pasi procedura për fillimin e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore nuk kishte nisur dhe nuk mund të vijohej.

Në pozicionin nr. 15, datë 18.01.2023 që i referohet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nuk kishte kandidatë të kualifikuar me 2 (dy) vlerësime. Në këto rrethana Këshilli, në zbatim të pikës 49 të vendimit 320/2020, me vendimin nr. 374, datë 13.07.2023 ka vendosur: “Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën Shkallës së Parë të Juridiksionit të përgjithshëm Tiranë, të shpallur me vendimin nr. 14, nr. 19 dhe nr. 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim.”. Kandidate nga pozicioni nr. 15 në këto kushte është vetëm znj. {...}. Po në këtë vendim është caktuar nëpërmjet procedurës së shortit edhe relatori për çdo kandidat, për të cilin është përfshirë në vendimin e mësipërm.

Sipas pikës 7, të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në një procedurë lëvizje paralele për një pozicion të lirë, Këshilli i Lartë Gjyqësor bën renditjen e kandidatëve *që përmbushin kriteret*, renditje kjo që bëhet në funksion të përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, i cili do të duhet të transferohet nëpërmjet mekanizmit të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në atë pozicion të lirë.

Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit, të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në rastin konkret, Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësimit nga i vetmi kandidat të tre kritereve të mëposhtme: “përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Kështu, për kandidaten e vetme, znj. {...}, në përfundim të fazës së parë të lëvizjes paralele në përputhje me parashikimet e Kreut V të vendimit 320/2020 Këshilli verifikoi plotësimin nga ai të kritereve të kandidimit. Këshilli, me Vendimin nr. 448, datë 24.07.2023, vendosi kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin, nr.14 dhe nr. 15 datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Siç u parashtrua, krahas procedurave të verifikimit të kritereve të kandidimit, paralelisht, për kandidaten kanë vijuar edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional. Duke qenë se kandidatja përfshihej në listën e gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim për të ishte e nevojshme përfundimi i vlerësimit, konkretisht sipas përcaktimeve ligjore.

Këshilli, me vendimin nr. 294, datë 30.05.2023, kishte vendosur fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë edhe për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr. 15, datë 18.01.2023, duke u caktuar edhe relatori i çështjes.

Kandidatja është njoftuar në vijim për pozicionin e lirë si dhe për caktimin e relatorit e cila nuk ka paraqitur ndonjë kundërshtim apo kërkesën për përjashtimin e relatorit apo ndonjë nga anëtarët e Këshillit.

Në zbatim të pikës 106, të vendimit të Këshillit 320/2020, relatori ka administruar dokumentacionin përkatës për kandidaten e kualifikuar, që gjendej në dosjet e saj personale apo në praktikën dokumentare të procedurave të verifikimit të plotësimit të kritereve të kandidimit. Po ashtu, relatori ka administruar: i) vendimin përkatës të Këshillit në lidhje me vlerësimin etik dhe profesionale për kandidaten e kualifikuar; ii) certifikatat e vlerësimit të Shkollës së Magjistraturës për kandidaten, si edhe klasifikimin

e kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, për kandidatët e diplomuar në qershor 2018.

Konkretisht, lidhur me vlerësimet e Shkollës së Magjistraturës, për kandidaten u konstatua se: Kandidatja znj. {...} e diplomuar në vitin akademik 2017-2018 në përfundim të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës (tetor 2015 - qershor 2018) ka marrë vlerësimin “Shumë mirë”, me një total prej 3872.02 pikësh.

Konkretisht, lidhur me vlerësimin etik dhe profesionale, për kandidaten e vetme znj. {...} u konstatua se me vendimin e Këshillit nr. 536, datë 12.10.2023, është vlerësuar për periudhën 2020-2022.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në kushtet kur në këtë procedurë lëvizje paralele ka kandiduar vetëm një kandidate dhe, për rrjedhojë, edhe në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve është vetëm një e tillë, u vlerësua se nuk ka vend për ndjekjen e hapave, kriterëve dhe përparësive sipas përcaktimeve të Kreut VI, Seksioni C të vendimit 320/2020 të KLGJ-së, në funksion të renditjes së kandidatëve. Nga ana tjetër, në respektim të përcaktimeve të Seksionit D, Kreu VI, të vendimit 320/2020, relatori përgatiti projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 15, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Meqenëse kandidatja znj. {...} është e vetme në këtë procedurë të lëvizjes paralele, së bashku me projektvendimin e renditjes po përcillet edhe projektvendimi për transferimin e znj. {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Nga informacioni i përcjellë nëpërmjet postës elektronike nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, ajo ka vetëm 1 (një) çështje në fazën e konkluzioneve përfundimtare, për të cilën propozohet që të përfundojë shqyrtimin e saj.

Projektvendimi është i strukturuar në 2 pika.

Në pikën e parë ju propozohet renditja e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për

pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 15, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: 1) znj. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit, përcaktohet se një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidaten znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Së fundi, në projektvendimin përcaktohet se ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërsa, projektvendimi “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 15, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, u shqyrtua nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i cili pasi ka konstatuar si të plotë dokumentacionin e administruar për kandidaten, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Sa i përket projektvendimit “Për transferimin e gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele...”, ai është i strukturuar në 4 pika.

Në pikën e parë parashikohet transferimi i gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në pikën e dytë parashikohet se, gjyqtarja znj. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare.

Në pikën vijuese parashikohen efektet juridike të këtij vendimi, e cila vlen që të diskutojmë të gjithë së bashku se kur do të bëhet efektiv.

Në pikën katër parashikohet se një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Së fundmi, parashikohet që ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pra vlen të diskutojmë pjesën e afatit se kur do të fillojë t’i japë efektet juridike ky vendim.

(Diskutohet data e fillimit të efekteve juridike.)

Atëherë, pas diskutimeve që u bënë, propozohet që efektet juridike të këtij vendimi të fillojnë nesër, pra me datë 19.10.2023.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hallunaj!

Në parastresën e zotit Hallunaj u parashtrua edhe relacioni në lidhje me projekt-aktin që ka të bëjë me transferimin e gjyqtarës znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, fillimisht do hedhim në votim projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 15, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 15, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 15, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Meqenëse nuk kishte diskutime dhe pas plotësimit në lidhje me efektet juridike të fillimit të vendimit në lidhje me transferimin e gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ftoj anëtarët në votimin e aktit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për transferimin e gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Transferimin e gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

2. Gjyqtarja znj. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare.

3. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 19.10.2023.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.10.2023)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:31 dhe mbaroi në orën 14:39.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

9. Brikena Ukperaj (anëtare)

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim 1: Nuk merr pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Naureda Llagami**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.

2. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

3. Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).

5. Arturo Valdes dhe Arben Lila, përfaqësues nga EU4JUSTICE (në sallë).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

7. BIRN, si dhe përfaqësues të tjerë nga mediat.

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Në kuadër të përpjekjeve që ka bërë Këshilli i Lartë Gjyqësor për plotësimin e vakancave, në mënyrë të veçantë për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, kanë filluar procedurat e lëvizjes paralele. Pikërisht pozicioni nr. 19 është pasqyrim i kësaj procedure. Për pozicionin nr. 19 kanë kandiduar magjistratët {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}.

Me vendimin nr.77, datë 13.02.2023, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë janë përfshirë vetëm 2 (dy) kandidatë: {...} dhe {...}.

Për këta kandidatë janë kryer disa veprime procedurale. Me vendimin nr. 115, datë 13.03.2023, Këshilli ka vendosur: “I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele...” Ndërkohë, për zotin {...} Këshilli, me vendimin nr.383, datë 17.07.2023 ka vendosur: “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 18, nr.19 dhe nr. 20, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Ndërkohë zoti {...} tërhiqet, dhe Këshilli i detyruar, me vendimin nr. 331, datë 21.06.2023 ka vendosur përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për të.

Me vendimin nr.278, datë 25.05.2023 nga ana e Këshillit është vendosur: “...Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele, të kandidates znj. {...}, për shkak të transferimit të kandidates pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 218, datë 28.04.2023 të Këshillit...”.

Në vijim ndjekjes së procedurave për lëvizjen paralele për këtë pozicion të lirë kandidatët z, {...}, znj. {...}, kandidatë që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim, referuar vendimin nr.77, datë 13.02.2023, si dhe znj. {...} dhe z. {...}, kandidatë që kanë dhe mund të kenë një vlerësim, referuar vendimit nr.77, datë 13.02.2023, u tërhoqën nga kandidimi i tyre për këtë pozicion të lirë.

Në pozicionin nr. 19 datë 18.01.2023 që i referohet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Tiranë nuk kishte kandidatë të kualifikuar me 2 (dy) vlerësime. Në këto rrethana Këshilli, në zbatim të pikës 49 të vendimit 320/2020, me vendimin nr. 374, datë 13.07.2023 ka vendosur: “Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të shpallur me vendimin nr. 14, nr. 19 dhe nr. 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë që kanë ose mund të kenë 1 (një) vlerësim.” Kandidatët ishin {...} dhe {...}.

Për z. {...} dhe kandidaten tjetër znj. {...} janë kryer disa veprime procedurale, me qëllim finalizimin e procedurës së lëvizjes paralele. Kështu për z. {...}, me vendimin nr.449, datë 24.07.2023 është vendosur “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ...”.

Ndërkohë, për shkak të tërheqjes së zotit {...} Këshilli është detyruar me vendimin nr. 517, 05.10.2023, të vendosë përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023.

Ndërkohë që për zonjën {...}, Këshilli ka kryer veprime të tjera procedurale, ku me vendimin nr. 521, datë 05.10.2023 ka vendosur: “...Për kualifikimin e znj {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Ndërkohë, duke qenë e vetme, në përfundim të fazës së farë të lëvizjes paralele, në përputhje me parashikimet e Kreut V të vendimit 320/2020 Këshilli verifikoi plotësimin nga ajo të kriterëve të kandidimit. Këshilli, me vendimin nr. 521, datë 05.10.2023, vendosi kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin, nr.19, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Siç u parashtrua, krahas procedurave të verifikimit të kriterëve të kandidimit, për këtë kandidate, ishte përfunduar dhe procedura e vlerësimit etik dhe profesional, për

periudhën e vlerësimit 2018-2020, gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë.

Me vendimin nr. 294, datë 30.05.2023, nga ana e Këshillit ishte vendosur fillimi i procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele.

Në zbatim të pikës 106, të vendimit të Këshillit 320/2020, nga ana e relatorit janë administruar aktet e nevojshme të cilat do të shërbenin për të përfunduar renditjen e vlerësimit, siç ishin: i) vendimi përkatës i Këshillit në lidhje me vlerësimin etik dhe profesionale për kandidaten e kualifikuar; ii) certifikatat e vlerësimit të Shkollës së Magjistraturës për kandidaten, si edhe listën e klasifikimit të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, për kandidatët e diplomuar në qershor 2015.

Konkretisht, lidhur me vlerësimet e Shkollës së Magjistraturës, për kandidaten u konstatua se: Kandidatja znj. {...} e diplomuar në vitin akademik 2012-2015 në përfundim të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës (tetor 2012 - qershor 2015) ka marrë vlerësimin “Shumë mirë”, me një total prej 4428.13 pikësh.

Lidhur me vlerësimin etik dhe profesionale, për kandidaten e vetme znj. {...} u konstatua se: Me vendimit të Këshillit nr.7, datë 18.01.2023, kandidatja është vlerësuar për periudhën 2018-2020 gjatë ushtrimit të detyrës së ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 395 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim.

Vlerësimi etik dhe profesional i kandidates z. {...} i miratuara me vendimin e Këshillit nr.7, datë 18.01.2023, u konstatua të jetë bërë përfundimtar, ndërsa ndaj tij nuk është bërë asnjë ankim.

Kandidatja e vetme e renditur më lart në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 19, datë 18.01.2023, pra znj. {...} pavarësisht kandidimit edhe për pozicione të tjera të lira për transferimin nëpërmjet lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, konstatohet që, në momentin e kandidimit, të mos ketë shprehur preferenca kandidimi sikurse përcaktohet në pikën 5, të nenit 43, të Ligjit për Statusin. Për pasojë, për këtë kandidate është e pazbatueshme preferenca e kandidimit.

Përfundimisht, nga ana e relatorit, në përputhje me aktet e administruara është përpiluar projektvendimi, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë

në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.10.2023)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtarës {...}”, (relatore znj. Yllka Rupa).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:31 dhe mbaroi në orën 14:39.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk merr pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.

2. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

3. Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).

5. Staf nga administrata e KLGJ-së.

6. BIRN, si dhe përfaqësues të tjerë nga mediat.

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtares {...}”, (relatore znj. Yllka Rupa).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtares {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni përkatës. Për më tej fjalën relatores znj. Rupa.

Yllka Rupa: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Të nderuar kolegë!

Në cilësinë e relatores në procedurën e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2013-2016 (gradim) të gjyqtares {...}, do të prezantoj përpara

Këshillit një përmbledhje të analizës së të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit si dhe propozimin për nivelin e vlerësimit për gjithsecilin nga katër kriteret e vlerësimit

1. Aftësitë profesionale të gjyqtarës

Aftësia profesionale e gjyqtarës pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor, të cilët ndahen në disa nëntregues.

1.A. Njohuritë ligjore

“Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimin e normës konkrete procedurale dhe materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive, në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Për këto arsye vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin e “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe konfliktin normave” duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, pikëzimi 25 pikë.

Për sa i takon “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën e Gjykatës Kushtetuese, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës.

Për këto arsye, edhe në lidhje me këtë tregues, propozohet niveli i vlerësimit “Shumë i lartë”, pikëzimi 25 pikë.

Arsyetimi ligjor – “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e mirë të ligjit. Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe shmang përdorimin e fjalëve fyese apo denigruese. Përdor përgjithësisht të gjitha shkronjat e alfabetit. Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte

dhe konsistente, vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh. në ligjet e posaçme të përdorura nga ana e gjykatës në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

Propozohet në lidhje me këtë tregues niveli i vlerësimit “Shumë e lartë”, pikëzimi 15 pikë.

“Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit gjyqësor”.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar në hartimin e vendimit, i referohet prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjyqtarja ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke iu përshtatur edhe gjykimit në apel, për shkak të të cilit i duhet të citojë edhe vendimmarrjen objekt ankimi, si dhe shkaqet e ankimit të palëve. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Në këto kushte, edhe lidhur me këtë nënkriter propozohet niveli i vlerësimit “Shumë i lartë”, pikëzimi 10 pikë.

Cilësia e analizës dhe argumentit logjik - nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se në tërësi, në të gjitha aktet e analizuara rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithnjë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale. Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material.

Në këto kushte, edhe lidhur me këtë komponent, pra “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”, në lidhje me gjyqtaren {...} duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzimi 25 pikë.

Në mënyrë të përmbledhur propozimi për nivelin e vlerësimit në lidhje me kriterin “Aftësitë profesionale të gjyqtarës” është niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Sa i takon 2. Aftësive organizative të gjyqtarës.

2A aftësia për të përballuar ngarkesën në punë - 2.A.a. Respektimi i afateve ligjore.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës {...}, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 (tre) vendimeve të zgjedhura nga vetë gjyqtarja.

Nga vëzhgimi i 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, referuar kategorisë së çështjeve rezulton se në 12 (dymbëdhjetë) prej tyre parashikohet afat ligjor brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i çështjes.

Për 12 (dymbëdhjetë) çështjet për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, sikundër referohet më sipër, 9 (nëntë) prej tyre kanë përfunduar në tejkalim të afatit ligjor, pra gjyqtarja rezulton të ketë gjykuar 75% të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Në metodologjinë e pikëzimit, lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Në rastin konkret, në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, rezulton se gjyqtarja ka përfunduar në total për gjithë periudhën 3-vjeçare të vlerësimit 1153 çështje, nga të cilat 607 çështje administrative dhe 546 marrëdhënie pune, mesatarisht rreth 384 çështje në vit, pa përfshirë këtu ngarkesën si anëtare e trupit gjykues. Në lidhje me aspektin e rritjes së papritur të volumit të punës, rezulton se gjatë vitit 2014 volumi i punës në Gjykatën Administrative të Apelit është

rritur ndjeshëm si pasojë e vendimit unifikues nr. 3, datë 06.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku rezulton se gjatë vitit 2014 gjyqtares i janë caktuar 1678 çështje, mesatarisht rreth 140 çështje në muaj. Po kështu, në lidhje me aspektin e kushteve të punës, rezulton se për periudhën në Gjykatën Administrative të Apelit nuk ishin pjesë e organikës së saj ndihmësit ligjorë, sikurse parashikohej në nenin 6 të ligjit 49/2012, çka do të ndikonte ndjeshëm në lehtësimin e ngarkesës së punës në këtë gjykatë.

Në këto kushte për pikëzimin e këtij treguesi, në cilësinë e relatores kam vlerësuar: (i) raportin e çështjeve të gjykuara në tejkallim të afatit ligjor, që rezulton në masën 75% (ii) ngarkesën e gjyqtares si relatores (në total ka gjykuar 1153 çështje ose 384 çështje në vit) (iii) rritja e papritur të volumit të punës (për vitin 2014) dhe (iv) aspektet që lidhen me kushtet e punës. Prandaj propozoj që gjyqtarja për këtë tregues të vlerësohet në nivelin maksimal të tij, me 15 pikë.

Në lidhje me “Plotësimin e standardeve minimale kohore”

Nga vëzhgimi i 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, referuar kategorisë së çështjeve rezulton se vetëm për 2 (dy) prej tyre nuk parashikohet afat ligjor, brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit. Konkretisht, çështja që i përket vendimit nr. 4, datë 27.01.2016, është shqyrtuar nga kjo gjykatë, në bazë të kompetencës funksionale të saj, duke e gjykuar si gjykatë e shkallës së parë, si dhe çështja që i përket vendimit nr. 2595, datë 15.09.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit, të shqyrtuar në seancë gjyqësore në prani të palëve.

Referuar 2 (dy) çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor për gjykimet civile në gjykatën e apelit, do të rezultonte se:

(i) Çështja që i përket vendimin nr.4, datë 27.01.2016, është regjistruar në gjykatë në datën 24.04.2015, duke përfunduar gjykimin për 9 muaj e 3 ditë, tej afatit 6-mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile në gjykatën e apelit.

(ii) Çështja me nr.6821 regjistri, me objekt “Anulim/shfuqizim njoftim vlerësimi”, rezulton se është regjistruar në gjykatë në datën 05.09.2014 dhe me shortin elektronik të datës 31.03.2016 i është caktuar gjyqtares {...}, në cilësinë e relatores. Nga aktet e dosjes rezulton se ajo është vënë në lëvizje nga gjyqtarja në datën 06.04.2016 dhe ka

përfunduar në datën 15.09.2016. Pra referuar të dhënave të sipërcituara rezulton se çështja ka përfunduar për 5 muaj e 9 ditë nga data e nxjerrjes për gjykim, brenda afatit 6-mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile në gjykatën e apelit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, pikëzimi për këtë tregues përcaktohet duke iu referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor, me numrin total të çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji nuk parashikon afat ligjor gjykimi. Duke iu referuar këtij përcaktimi, nëse për çështjen e gjykuar për të cilën zbatohet standardi minimal kohor, do të zbatohet standardi minimal kohor për gjykimet civile në gjykatën e apelit, raporti i çështjeve të gjykuara tej standardit me totalin e çështjeve për të cilit zbatohet standardi minimal kohor, do të rezultonte 50%. Por vlerësuesi veç analizës matematikore duhet të kryejë edhe një analizë logjike të të dhënave, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Në këtë kontekst u analizua kompleksiteti i çështjes, volumi i çështjeve, të përcaktuara në metodologji si komponentët që mund të çojë në një pikëzim më të lartë se ai që rezulton nga analiza matematikore.

Çështja që i përket vendimit nr.4, datë 27.01.2016 i Gjykatës Administrative të Apelit, me objekt “Shfuqizim (anulim) vendimi të Këshillit të Bashkisë Sarandë për miratimin e paketës fiskale...”. Referuar të dhënave të vendimit rezulton se çështja mban si datë regjistrimi datën 24.04.2015 dhe datën e përfundimit 27.01.2016, duke përfunduar brenda një afati prej 9 muajsh e 8 ditë, pra jashtë standardit minimal kohor prej 6 muaj të miratuar. Afati i tejkalimit të çështjes nga standardi minimal kohor është rreth 3 muaj, por këtu duhet të mbahet në vëmendje edhe fakti se muaji gusht përkon edhe me pushimet vjetore të gjyqtarëve, e në këtë kontekst nuk duhet të përlogaritet në afatin e përfundimit të çështjes duke rezultuar tejkalimi vetëm rreth 2 muaj. Në dosje nuk ka të dhëna në lidhje me shkaqet e shtyrjeve të seancave gjyqësore apo me mënyrën e planifikimit dhe menaxhimit të çështjes, pasi ky vendim është vendim i përzgjedhur nga ana e gjyqtares. Po kështu në arsyetimin e vendimit nuk ka të dhëna lidhur me ecurinë procedurale të çështjes, në mënyrë që shkalla e kompleksitetit të mbahet parasysh nga vlerësuesi në përcaktimin e shkallës së aftësisë e pikëzimit e gjyqtares.

Nga ana tjetër, në aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, evidentohet se gjyqtarja ka përfunduar në total për gjithë periudhën 3-vjeçare të vlerësimit 1153 çështje, nga të cilat 607 çështje administrative dhe 546 marrëdhënie pune, mesatarisht 384 çështje në vit ose 12% më shumë se standardit minimal i punës.

Në këto kushte, propozoj që lidhur me këtë tregues gjyqtarja të pikëzohet në nivelin maksimal, pra me 5 pikë.

Sa i takon “Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, duke marrë në konsideratë faktin se në të dhënat e analizuara lidhur me kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është analizuar vetëm për dy prej çështjeve të gjykuara, duke mos pasur të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për çështjet të tjera të gjykuara po në bazë të kompetencës funksionale, apo të shqyrtuara në seancë gjyqësore, si dhe duke marrë në konsideratë, aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara për gjithë periudhën 3-vjeçare të vlerësimit, vlerësoj se edhe në lidhje me këtë tregues “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, të vlerësohet maksimalisht, “Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha e kategoritë e çështjeve”.

Lidhur me “Rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore” - për të gjithë periudhën e vlerësimit rezulton se gjyqtarës i janë caktuar në total 3475 çështje dhe ka përfunduar me vendim deri në tetor 2016, 1153 çështje. Sa i përket rendimentit sipas këtyre të dhënave, rezulton një normë likuiditeti çështjesh prej 33.17%.

Referuar akteve normative, vlerësuesi nuk bën vetëm një analizë matematikore për të përcaktuar rendimentin e përfundimit të çështjeve, por ai bazohet edhe në kompleksitetin e çështjeve. Ky vlerësim mund të shkojë deri në pikëzimin maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar gjatë vitit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës në fuqi. Në rastin konkret, rezulton se gjatë vitit 2014 volumi i punës në Gjykatën Administrative të Apelit është rritur ndjeshëm si pasojë e vendimit unifikues që u citua më lart, ku rezulton se gjatë vitit 2014 gjyqtarës i janë caktuar 1678 çështje, mesatarisht rreth 140 çështje në muaj, fakt ky që ndikon në llogaritjen matematikore të normës së likuidimit të çështjeve. Në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, rezulton se gjyqtarja për periudhën e vlerësimit ka përfunduar dukshëm më shumë se standardi minimal i ngarkesës i përcaktuar për gjyqtarin e gjykatës së apelit

dhoma civile (92% më shumë, 384 çështje në vit, nga 200 të përcaktuara si standard minimal). Po kështu, në lidhje me kushtet e punës, rezulton për këtë periudhë vlerësimi mungesa e ndihmësve ligjorë, si strukturë mbështetëse e gjykatës, gjithashtu edhe arsye të tjera të cilat kanë penalizuar gjyqtaren (të cilat ajo i ka shpjeguar me hollësi dhe janë paraqitur në mënyrë të detajuar në raportin e vlerësimit).

Në këto kushte, unë propozoj që edhe në lidhje me “Rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore”, kjo gjyqtare të pikëzohet në nivelin maksimal me 10 pikë.

Sa i takon “Kohës mesatare të arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor” - Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh, krahasuar me afatin ligjor 7-ditor të parashikuar në nenin 55 të ligjit nr. 49/2012, është i tillë:

- Në çështjet e kategorisë “Administrative me palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit është 42 ditë;

- Në çështjet e kategorisë “Marrëdhënie pune”, koha mesatare e arsytimit të vendimit është 55 ditë.

Pra, koha mesatare e arsytimit të vendimit është më e gjatë se afati 7-ditor i përcaktuar në nenin 55, të Ligjit nr.49/2012, për të gjitha kategoritë e çështjeve, duke përkuar kjo gjendje me një rezultat vlerësimi prej 3 pikësh.

Sipas metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave burim vlerësimi bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin, rritjen e papritur të volumit dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së gjyqtarës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë , duke zbatuar një koefiçient jo më shumë se 20%. Në rastin konkret, lidhur me këtë tregues duke pasur në konsideratë të gjithë këto aspekte që u analizuan edhe në treguesit që lidhen me rendimentin, në këtë nëntregues është gjykuar që gjyqtarja të rritet në një nivel dhe të vlerësohet me 6 pikë komponentin “Koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar”.

Në lidhje me “Aftësia e gjyqtarës për të kryer procedurat gjyqësore”

“Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive”.

Për këtë tregues, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short, rezulton se numri i seancave gjyqësore është 6 seanca, por rezulton që gjyqtarja në çdo rast ka treguar kujdes, duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive, për planifikimin dhe zhvillimin e seancave me efektivitet. Propozohet niveli i pikëzimit me 15 pikë.

Në lidhje me “Kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” - Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale, vlerësohet bazuar ndër të tjera, edhe në shkallën e aftësisë dhe efikasitetit të treguar nga gjyqtarja në kryerjen e këtyre veprimeve, për shembull për fillimin pa vonesë të seancave gjyqësore. Përgjithësisht, rezulton se shkak për fillimin me vonesë të seancave gjyqësore është bërë zgjatja e gjykimeve të mëparshme. Nga ana tjetër, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë në drejtim të zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit në apel administrativ, në dhomë këshillimi, apo në seancë gjyqësore.

Në këto kushte, bazuar në këto tregues, është vlerësuar dhe propozohet që në lidhje me këtë tregues, gjyqtarja të pikëzohet me 20 pikë.

“Aftësia e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore” – “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” gjithashtu dhe “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes”, propozohet të vlerësohen maksimalisht, përkatësisht në 5 dhe 10 pikë.

Kështu që në mënyrë të përmblodhur niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtarës” propozohet të jetë "Shkëlqyeshëm", pikët 91.

Për të kaluar tek kriteri tjetër “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, “Etika në punë”.

Lidhur me këtë nënkriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren {...} përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore”.

Në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion, më duhet të relatoj një ankesë lidhur me këtë komponent.

Referuar akteve burim vlerësimi, rezulton se në datën 08.02.2018 në KPK është regjistruar ankesa me nr.{...} prot., me ankues shtetasin {...}, në të cilën ngrihen pretendime për shkelje të etikës gjyqësore nga gjyqtarës {...}, gjatë ushtrimit të detyrës së saj në raport me ndihmësen ligjore. Këto pretendime të ankueses lidhur me fjalët e përdorura nga ana e gjyqtarës {...} në adresë të saj, janë shoqëruar me kopje të fletëve përkatësve të akteve (projektvendimeve/relacioneve), që sipas ankueses janë hartuar prej saj në cilësinë e ndihmësit ligjor dhe i përkasin periudhës 2017, përkatësisht muajve korrik, nëntor dhe dhjetor. Në kushtet kur faktet e referuara i përkasin vitit 2017, kjo çështje mund të trajtohet në kuadër të procesit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës, për periudhën e vlerësimit që përfshin vitin 2017.

Në këto kushte është vlerësuar që në lidhje me vlerësim e këtij komponenti pra shkalla e etikës në punë të gjyqtarës dhe pikëzimi për këtë periudhë vlerësimi 2013-2016 të vlerësohet në nivelin maksimal, ndërsa çështja në fjalë të analizohet në momentin kur të realizohet nga Këshilli vlerësimi i kësaj gjyqtareje për periudhën përkatëse.

Për të gjithë komponentët e tjerë të këtij kriteri, gjyqtarja propozohet të vlerësohet në nivelin maksimal dhe propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100 për kriterin "Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale", duke vlerësuar të gjithë treguesit në mënyrë maksimale.

Në lidhje me "Aftësinë personale dhe angazhimin profesional të gjyqtarës", "Aftësia e komunikimit", "Komunikimi i qartë dhe transparent" - Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve. Propozohet niveli i pikëzimit 25 pikë. Niveli i vlerësimit "Shumë i lartë".

"Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale" - Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale të subjektit të vlerësimit. Kështu që edhe

në lidhje me këtë komponent propozohet niveli i pikëzimit 15 pikë, nivel “Shumë i lartë” pikëzimi.

“Aftësia për të bashkëpunuar” – Në lidhje me këtë periudhë vlerësimi propozohet të jetë në nivel vlerësimi “Shumë të lartë” si në aspektin e shkallës së komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta – në nivelin e 15 pikëve, ashtu edhe në shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, propozohet një nivel vlerësimi “Shumë i lartë”, pikëzimi 10 pikë.

“Gatishmëria e gjyqtares për t’u angazhuar në veprimtari të tjera” – Lidhur me këtë nënkriter analizohet pjesëmarrja e gjyqtares në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, si dhe akteve të dorëzuara nga gjyqtarja nëpërmjet postës elektronike, evidentohet se gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtarja {...} nuk ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, por rezultojnë të ketë marrë pjesë në aktivitete profesionale jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, pra rezultojnë të ketë marrë pjesë në dy aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 3 ditë trajnimi.

Lidhur me këtë komponent, duke marrë në konsideratë këtë periudhë trajnimi propozohet niveli i pikëzimit me 20 pikë.

Për të kaluar tek “Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” - Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezultojnë që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si eksperte, lektore ose angazhimi i saj për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë stazhit profesional. Për këtë arsye, niveli i vlerësimit lidhur me këtë tregues do të jetë në nivelin e 3 pikëve.

Sa i takon “Angazhimit të gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, bazuar në analizën e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë komponent, nuk rezultojnë të tilla dhe propozohet niveli i vlerësimit për këtë tregues me 3 pikë

Gjithashtu edhe në lidhje me “Publikimet ligjore akademike”, nuk rezulton që gjyqtarja të ketë paraqitur të tilla dhe të ketë të tilla, prandaj lidhur me këtë komponent nuk vlerësohet, pra është 0 pikë.

Në mënyrë të përmbledhur, propozimi për nivelin e pikëzimit dhe të vlerësimit për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional për gjyqtaren” propozohet të jetë niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, pikët 91.

Në mënyrë të përmbledhur, propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi dhe niveli i përgjithshëm i vlerësimit për gjyqtaren {...} është si më poshtë:

1. Aftësitë profesionale të gjyqtares, pikët 100, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.
2. Aftësitë organizative të gjyqtares, pikët 91, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, pikët 100, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, niveli i pikëzimit 91, ai i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Propozimi për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit për gjyqtaren {...} është vlerësimi i përgjithshëm 382 pikë dhe niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Rupa!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Gjithashtu zonja {...} kishte marrë dijeni për shqyrtimin e këtij projektvendimi në mbledhjen e sotme, për të cilin ka konfirmuar me e-mail marrjen dijeni për këtë rend dite për shqyrtimin e këtij projektvlerësimi.

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projekt-aktit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.10.2023)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtarës {...}”, (relatore znj. Irena Plaku).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:31 dhe mbaroi në orën 14:39.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës*:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare)* |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk merr pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.

2. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

3. Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).

5. Staf nga administrata e KLGJ-së.

6. BIRN, si dhe përfaqësues të tjerë nga mediat.

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtarës {...}, (relatore znj. Irena Plaku).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një tjetër pikë të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtarës {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës nga Komisioni. Ndërkohë bëj me dije që nëpërmjet e-mailit është njoftuar zonja {...} mbi shqyrtimin e këtij projektvendimi për vlerësimin etik dhe profesional, nëpërmjet postës elektronike, dhe po me postë elektronike ka konfirmuar marrjen e njoftimit. Për më tej fjalën relatores znj. Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit!

Do ju paraqes në mënyrë të përmbledhur projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës {...}. Procedura e vlerësimit të saj ka filluar me vendimin nr.

336, datë 24.09.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ku fillimisht është caktuar si relator z. {...} dhe nëpunëse përgjegjëse {...}. Më pas janë bërë të gjithë procedurat për administrimin e akteve në kuadër të vlerësimit. Me vendimin nr. 93, datë 09.03.2022 jam caktuar unë si relatore zëvendësuese për vlerësimin e gjyqtares, të cilës i është njoftuar rregullisht dhe nuk ka pasur kundërshtime.

Me vendimin e datës 17.11.2022, është gjetur e plotë dosja e vlerësimit.

Në pjesën e parë të projektraportit janë burimet e vlerësimit: formulari i vetëdeklarimit, të dhënat e dosjes personale të gjyqtares, të dhënat statistikore, nga ku ka rezultuar se për periudhën e vlerësimit 2013-2016 gjyqtarja ka gjykuar pranë gjykatës së apelit dhe nga të dhënat statistikore rezulton se ajo ka gjykuar pranë kësaj gjykate rreth 1066 çështje, nga të cilat: 675 civile të përgjithshme, 14 familjare dhe 377 penale, nga të cilat 55 çështje penale themeli dhe 322 masa sigurimi.

Gjatë periudhës së vlerësimit ajo ka qenë e deleguar edhe pranë Gjykatës Administrative të Apelit ku ka gjykuar rreth 50 çështje, si dhe anëtare e Kolegjit Zgjedhor ku për vitin 2015-2016 ka gjykuar 7 çështje si relatore.

Gjithashtu janë dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja; janë administruar vendimet e administruara për shkak të ankesave, kryesisht nga organet e rivlerësimit, ku kanë rezultuar tre vendime, ku për efekt vlerësimi janë marrë 2 për shkak se njëri prej tyre është jashtë periudhës së vlerësimit; burime të të dhënave arkivore nga KLGJ-ja, ku kanë rezultuar dy materiale të cilat janë evidentuar për efekt vlerësimi dhe janë marrë parasysh në kriteret përkatëse të vlerësimit; gjithashtu është edhe raporti i analizimit të aftësive profesionale të hartuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Në pjesën e dytë janë përshkruar burimet e vlerësimit, konkretisht katër dosjet e përzgjedhura me short në procedurën e vlerësimit me qëllim gradimin e gjyqtares. Janë përshkruar në mënyrë të detajuar në këtë pjesë të projektraportit deri në faqen 34.

Më pas, në vijim është bërë analiza e të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit dhe propozimi për nivelin e vlerësimit për 4 kriteret e vlerësimit.

“Aftësitë profesionale të gjyqtares”, “Njohuritë ligjore”.

Duke u nisur nga burimet e vlerësimit, të gjitha vendimet e nënshtruar kësaj analize, pavarësisht natyrës së gjykimit, ka rezultuar se faktet parashtrohen në pjesën e parë të pjesës përshkruese – arsyetuese të vendimit megjithëse nuk rezultojnë të jetë e ndarë me rrethanat e faktit. Tipar i vendimeve është analiza e detajuar e të gjitha provave të marra në gjykim dhe fuqia provuese e tyre në funksion të konkluzionit mbi ekzistencën ose jo të faktit penal dhe cilësimin juridik të tij, apo në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në çështjet civile. Gjyqtarja nxjerr faktin juridik siç ka rezultuar nga shqyrtimi gjyqësor. Identifikon qartë natyrën e çështjes. Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën. Gjyqtarja evidenton qartë dhe identifikon ligjin e zbatueshëm duke tregues gjithashtu kujdes në moscitimin apo listimin e dispozitave të cilat nuk i përkasin çështjes. Identifikon si ligjin material dhe procedural ashtu edhe ligjin e posaçëm kur ka qenë e nevojshme.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimin e normës konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Pas analizimit të të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

“Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normave juridike që gjejnë zbatim si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore përmenden apo citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes. Citimi i dispozitave shoqërohet gjithmonë me interpretimit të tyre abstrakt dhe mbi faktin konkret ose konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato përdoren. Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarës sipas mënyrës së interpretimit të tyre në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në këtë kontekst, konstatohet se gjyqtarja kryesisht përdor

interpretimin ligjor të normës konkrete duke e përdorur edhe faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, nxjerr konkluzionin e saj në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Janë analizuar dispozitat të cilat interpretohen nga ana e gjyqtares.

Në konkluzion, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe, kur është e nevojshme, në mbështetje të arsytimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, të GJEDNJ, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës. Aftësia e gjyqtares spikat kryesisht në evidentimin rast pas rasti të parimit interpretues të normës sipas objektit, qëllimit rregullues, gjithmonë në drejtim të zgjidhjes së çështjes. Mënyra e interpretimit të nocioneve ligjore të padetajuara nga ligji apo të pazhvilluara nga praktika, i jep vlerë arsytimit ligjor dhe e bën atë unik në vetvete.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues është shumë e lartë dhe duhet pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket treguesit “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”, rezulton se gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë. Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit. Përdor të gjitha shkronjat e alfabetit. Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht në ligj.

Në përdorimin e instituteve, parimeve, apo të drejtave të pjesëmarrësve në një procedim civil dhe penal, nuk përdor terma latine, por parimet apo institutet përdoren në gjuhën shqipe.

Në arsytimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të ndërthurura dhe të kuptueshme. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra tjetrës dhe paragrafët e arsytimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezulton të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Në konkluzion rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Mënyra e zgjedhjes dhe përdorimit të fjalëve siguron një balancim midis të shprehurit thjesht dhe konciz, me përdorimin e gjallë dhe të zhdërvjelltë të gjuhës shqipe.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësia e saj është “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 15 pikë.

“Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit”, referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës i përmbahet, si prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjyqtarja ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke iu përshtatur edhe gjykimit në apel, për shkak të së cilit i duhet të citojë edhe vendimarrjen objekt ankimi si dhe shkaqet e ankimit të palëve. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese dhe analizuese, si dhe dispozitivin.

Pjesa përshkruese megjithëse nuk është ndarë me nëntituj, referuar përmbajtjes së saj ajo është ndarë sipas këtyre rregullave: “rrethanat e faktit”, “ligji i zbatueshëm”, “analiza juridike”.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi konform nenit 466 të K.Pr.Civile (dhe penale).

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit sipas pjesëve përbërëse të tij. Në të gjitha vendimet e analizuar, ndjekja e një strukture të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërthurur mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëri paragraf në tjetrin dhe nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, i bën vendimet lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme dhe orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tyre.

Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtares për këtë tregues është shumë e lartë duke e pikëzuar me 10 pikë.

Sa i përket treguesit “Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik”.

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi të analizuara, rezulton një nivel shumë i mirë i arsytimi, gjithmonë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t'u analizuar në raport me aspektet procedurale, si në rastet kur ai përbën shkak ankimi ashtu edhe në rastet kur analiza e fakteve dhe dispozitave me natyrë procedurale është thelbësore.

Vendimet e saj janë gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, shkaqeve të ankimit, në të gjitha vendimet burim vlerësimi ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsytimit me të cilën lidhet pretendimi. Duke u marrë në shqyrtim dhe analizuar, në disa raste si pjesë e arsytimit ligjor dhe në disa raste komplekse në një pjesë të veçuar të arsytimit, pretendimet e palëve të cilat lidhen me shkaqet e ankimit gjithnjë kanë marrë një përgjigje të argumentuar, në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme si pjesë e arsytimit tërësor.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se aftësia e saj është shumë të lartë. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim ligjor-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik të gjyqtarës në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsytimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri dhe evidentohet interpretimi individual i ligjit, si dhe mbështetja e tij në qëndrimet e praktikës gjyqësore, dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës. Arsytimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve të cilat janë objekt ankimi apo çështjeve të shtruara për diskutim kryesisht në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Kështu, propozimi për kriterin e parë të vlerësimit është "Shkëlqyeshëm", pikëzimi 100 pikë.

Sa i përket kriterit “Aftësia organizative e gjyqtarit”, konkretisht “Respektimi i afateve ligjore”. Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar të dhënave statistikore, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja dhe 2 vendimeve të administruara për shkak të ankesave. Nga këto vendime, ka rezultuar që vetëm 2 çështje janë me afat ligjor. Një është kërkesë për vleftësim ndalimi dhe caktim mase sigurimi e cila ka rezultuar se është shqyrtuar brenda afatit 10-ditor ndërsa një vendim është vendim i zgjedhur nga ana e gjyqtares që ajo ka gjykuar si relatores e kolegjit zgjedhor. Këtu ka një gabim material sa i përket datës së regjistrimit pasur parasysh datën se kur është bërë ankimi, referuar përmbajtjes së vendimit. Ka rezultuar se për këtë vendim në fakt është bërë ankesë ndaj 130 vendimeve të KQZ-së. Nga përmbajtja e vendimit rezulton se në datën 08.01.2015 është vendosur bashkimi i tyre në një gjykim të vetëm, dhe më pas është caktuar seanca e radhës për shqyrtimin e tyre në datë 14.01.2015, në përfundim të cilës është marrë vendimi.

Po t’i referohemi datës kur nga Kolegji është marrë vendimi për bashkimin e 130 padive në një çështje më vete, datë 08.01.2015, në kushtet kur nuk ka të dhëna për kohën e shortimit të çështjeve, relatorin përkatës, si dhe datën e marrjes së vendimit, rezulton së gjykimi i çështjes në tërësi ka përfunduar brenda afatit 10-ditor të përcaktuar në nenin 157 të Kodit Zgjedhor.

Në dosje është administruar edhe një vendim me objekt “Lëshim i urdhrit të mbrojtjes”, por në atë kohë ka qenë në fuqi ligji me nr. 9669, para ndryshimeve të bëra në vitin 2018 me ligjin 48, nuk ka parashikuar një afat për shqyrtimin e tyre. Kështu që nuk do merret parasysh.

E njëjta situatë është edhe me një vendim tjetër “për lejim përgjimi” ku në kohën nuk është parashikuar afat për shqyrtimin e tyre.

Kështu, po t’i marrim në konsideratë këto të dhëna rezulton se edhe 2 çështjet të cilat parashikojnë afat janë shqyrtuar brenda afatit ligjor. Megjithatë, edhe po të marrim në konsideratë datën kur nga Kolegji Zgjedhor është vendosur bashkimi i padive apo po të marrim parasysh momentin e regjistrimit të kërkesë padisë, që ka të bëjë me

vendimin e dytë, me 130 paditë me 132 palë ndërgjyqëse, do të vlerësojmë se një çështje e tillë nuk mund të jetë përcaktues për të treguar që gjyqtarja nuk ka aftësi për respektimin e afateve ligjore.

Për sa më sipër, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, në çështjet e analizuara për të cilat ligji ka parashikuar afat shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre.

Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtares për këtë tregues është shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet me 15 pikë.

“Plotësimi i standardeve minimale”, edhe këtu burim vlerësimi janë vetëm 11 çështjet e analizuara të përzgjedhura me short, 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja dhe 2 vendimet e administruara për shkak të ankesave.

Në projektraport janë analizuar koha gjatë së cilës është shqyrtuar secili prej këtyre vendimeve dhe ka rezultuar që në të gjitha rastet, konkretisht në 14 vendime janë respektuar standardi minimal prej 6 muajsh nga koha e nxjerrjes për gjykim.

Për sa më sipër, duke qenë se përqindja matematikore me 0% përkon me nivelin e vlerësimit 5 pikë, vlerësoj se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me 5 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara jashtë standardit është 0%.

Sa i përket treguesit “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, edhe për këtë tregues, vlerësimi është bërë vetëm për 11 çështje të përzgjedhura me short, 1 vendim i përzgjedhur nga gjyqtarja për efekt vlerësimi (pasi 2 vendimet e tjera janë me afat ligjor) dhe 2 vendimeve të administruara për shkak të ankesave.

Në projektraport është përshkruar e gjithë koha që i është dashur gjyqtares për gjykimin e një çështjeje, nga ku ka rezultuar se koha mesatare e çështjeve të vëzhguara është më e shkurtër se standardi minimal për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Për sa më sipër, duke qenë se koha mesatare është më e shkurtër për të gjitha kategoritë e çështjeve, gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

Për sa i përket “Rendimentit të përfundimit të çështjeve”, referuar raportit analitik të vlerësimit të hartuar nga KLGJ-ja nuk rezulton që është llogaritur rendimenti i përfundimit të çështjeve. Në këto kushte është bërë një analizë lidhur me vlerësimin e

këtij treguesi duke pasur parasysh vërtetimet të cilat ndodheshin në dosje, nga ku ka rezultuar se rendimenti i përfundimit të çështjeve, duke pasur parasysh çështjet e përzgjedhura, konkretisht për vitin e plotë 2014 ka rezultuar 98.5%, për vitin 2015, ku në fakt gjyqtarja gjatë këtij viti ka gjykuar edhe si gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Administrativ dhe në Kolegjin Zgjedhor, rezulton se ka qenë 66.5%, dhe ëpr vitin 2016 rendimenti ka qenë 86.6%.

Në tërësi, raporti i çështjeve të përfunduara me atë të caktuara rezulton 84.9%, rendiment i cili përkon me nivelin e pikëzimit me 4 pikë.

Referuar metodologjisë së pikëzimit lidhur me këtë tregues përcaktohet se: “Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit....”

Për aspektin sasior sipas pikës 3, germa “h” të vendimit të ish KLD-së, nr. 261/2 është përcaktuar se gjyqtari i Gjykatës së Apelit që është organizuar në dhomë penale, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 150 çështjesh penale, i llogaritur në periudhën 3-vjeçare jo me pak se 450 çështje penale dhe gjyqtari i dhomës civile, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 çështje civile në vit, i llogaritur në periudhë 3-vjeçare, jo më pak se 600 çështje.

Në lidhje me respektimin nga ana e gjyqtarës të standardit sasior në fuqi, rezulton që gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit ka gjykuar gjithsej 1066 çështje, nga të cilat: 675 civile të përgjithshme, 14 familjare dhe 377 penale, nga të cilat 55 çështje penale themeli dhe 322 masa sigurimi personal. Gjyqtarja ka gjykuar dhe si e deleguar në Gjykatën Administrativ të Apelit, 50 çështje si dhe si relatores në Kolegjin Zgjedhor 7 çështje. Pra gjithsej ka gjykuar 1123 çështje. Më pas është bërë përkrahimi i ndarë në çdo vit.

Pra referuar periudhës së vlerësimit rezulton se ajo ka gjykuar rreth 640 çështje themeli (penale dhe civile), duke e tejkaluar standardin (po të marrim parasysh që ka qenë në dhomën civile megjithëse siç e relatuam më sipër ka gjykuar edhe çështje penale) me vetëm 40 çështje. Siç e theksuam ajo ka gjykuar edhe si relatores në Gjykatën Administrative të Apelit dhe në Kolegjin Zgjedhor për vitin 2014, 2015 dhe 2016.

Sipas të dhënave statistikore të Kolegjit Zgjedhor rezulton se gjatë vitit 2014 – 2016 ajo ka përfunduar 8 çështje si relatores dhe ka qenë si anëtare në 30 çështje.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit është 84.9 %, përqindje e cila pikëzohet me 4 pikë. Bazuar në të dhënat e tjera, konkretisht: (i) ngarkesën e përgjithshme në punë të gjyqtares, faktin se për të gjithë periudhën e vlerësimit, gjyqtarja e ka tejkaluar standardin minimale duke gjykuar 40 çështje më shumë; (ii) angazhimin e gjyqtares në plotësimin e trupave gjykues në gjykatën e apelit, pasi gjykimet zhvillohen me trup gjykues me tre gjyqtare, ku vetëm në vitin 2016, rezulton të jetë angazhuar në 417 çështje si anëtare, përveç 329 çështjeve si relatores; (iii) faktin se nxjerrja e çështjeve civile për gjykim në periudhën e vlerësimit, sipas nenit 460 të K.Pr.Civile ka qenë atribut i Kryetarit të Gjykatës; (iv) angazhimin e gjyqtares në gjykimin si relator dhe anëtare pranë Kolegjit Zgjedhor, në total në 38 çështje, të cilat paraqesin vështirë në gjykim, për të cilën Kodi Zgjedhor , në nenin 149 të tij ka parashikuar mundësinë e gjyqtarit për tu lehtësuar nga puna e tij e përditshme; (v) angazhimin e gjyqtares në gjykimin e 50 çështjeve në Gjykatën Administrative të Apelit, vlerësoj se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet maksimalisht, me 10 pikë.

Referuar sa më sipër, propozoj pikëzimin e saj për këtë tregues me 10 pikë.

“Koha mesatare e arsyetimit të vendimeve” – Referuar burimeve të vlerësimit, duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit është si më poshtë:

(i) Koha mesatare e arsyetimit të vendimit për kategoritë penale krime, është 28.5 ditë.

(ii) Koha mesatare e arsyetimit të vendimit për kategorinë civile themeli, për 7 dosje, është 46.8 ditë.

(iii) Koha mesatare e kërkesave penale, është 5 ditë.

(iv) Koha mesatare e arsyetimit të vendimit për kategoritë kërkesa civile, është 13 ditë.

(v) Koha mesatare çështjeve familjare/ urdhër mbrojtje, për 1 dosje është 42 ditë.

Duke qenë se rezulton se afati i arsyetimit të vendimit është më i shkurtër se afati

procedural për shumicën e kategorive, referuar metodologjisë së vlerësimit, pikëzohet me 12 pikë.

Sipas metodologjisë së pikëzimit, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave burim vlerësimi bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%.

Referuar të gjitha të dhënave që në fakt i relatova tek treguesi tjetër, pasur parasysh ngarkesën dhe angazhimet e saj, vlerësoj se pikëzimi i saj duhet të rritet me një nivel, duke shkuar në pikëzimin 15 pikë.

Sa më sipër propozoj pikëzimin e saj për këtë tregues me 15 pikë.

“Numri mesatar i seancave”, në projektraport janë përcaktuar numri i seancave të zhvilluara për secilën prej çështjeve për të cilat ka të dhëna në dosje, nga ku ka rezultuar se për 9 çështje janë zhvilluar rreth 17 seanca. Numri mesatar i seancave, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 1.8 seanca gjyqësore.

Nga vëzhgimi i dosjeve të përzgjedhura me short, rezulton se gjyqtarja ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural civil dhe penal. Gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta.

Sa më sipër, edhe për këtë tregues, duke qenë se numri mesatar është më i vogël se 3, propozoj pikëzimin e saj me 15 pikë për këtë tregues.

“Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit”, edhe këtu si burim vlerësimi janë 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, 9 prej tyre janë me palë kundërshtare, 2 prej të cilave i përkasin kategorisë “penale krime”, 6 çështje i përkasin kategorisë “civile me palë kundërshtare”, 1 çështje i përket kategorisë “familjare me palë kundërshtare (urdhër mbrojtje)”, ndërsa 2 çështjet e tjera janë pa palë kundërshtare, nga të cilat 1 i përket kategorisë së kërkesave penale të hetimit paraprak.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i

rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligj për gjykimin në apel (civil dhe penal).

Në tërësi, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit kur ajo e ka pasur këtë të drejtë, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

Sa më sipër, për këtë tregues propozohet pikëzimi i saj me 20 pikë.

“Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen” edhe këtu gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë të aftësisë, evidentuar në korrektësinë e zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësia e saj është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 5 pikë.

“Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit” - Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, pasi në rastet kur evidentohet mungesa e aktit procedural për nxjerrjen e çështjeve civile për gjykim, kjo nuk ka qenë detyrë e gjyqtarit relator, por e Kryetarit të Gjykatës. Gjithsesi kjo mungesë nuk ka sjellë asnjë pasojë procedurale në zhvillimin e gjykimit dhe përfundimin e tij, pasi në cilësinë e relatores gjyqtarja ka marrë të gjitha masat për mbikëqyrjen e njoftimit të palëve për seancën e parë gjyqësore nga ana e sekretarisë gjyqësore. Për çdo gjykim civil në apel gjyqtarja ka verifikuar njoftimet me shpallje si kur palët kanë qenë prezent ashtu edhe kur ato nuk janë paraqitur, duke relatuar këtë fakt në seancë gjyqësore. Asnjë veprim apo mosveprim nga ana e saj nuk ka ndikuar në mos zhvillimin e seancave gjyqësore efektive.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësia e gjyqtares për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin e “Aftësive organizative” është 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Sa i përket kriterit “Etik dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, edhe për këtë tregues rezulton se duke iu referuar burimeve të vlerësimit, konkretisht konkluzionet e arritura në raportin analitik, burimeve arkivore të KLD-së dhe KLGJ-së, të dhënat për masat disiplinore, nga ku nuk ka rezultuar që të ketë marrë masë disiplinore, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë. Për këtë arsye për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion. Sa më sipër, propozohet pikëzimi i saj me 35 pikë.

E njëjta situatë është edhe tek kriteri “Integriteti i gjyqtarit”, nuk rezultojnë të dhëna që mund të afektojnë këtë tregues. Për sa më sipër propozohet pikëzimi i saj maksimal.

“Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti”, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet për këtë tregues nuk rezulton asnjë e dhënë apo sjellje e pahijshme apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit. Edhe për këtë tregues propozohet pikëzimi i saj me 40 pikë.

“Paanësia e gjyqtarës”, “Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese” – Nga burimet e vlerësimit rezulton se në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin me palët në proces ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese. Për sa më sipër propozoj pikëzimin e saj me 10 pikë.

“Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtim” - Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuara të palëve për përjashtim. Për këtë arsye, edhe për këtë tregues, vlerësoj se aftësia e saj është shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet me 15 pikë, pasi numri i kërkesave të pranuara prej palëve është i pakonsiderueshëm.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për sa i përket kriterit “Etika dhe angazhimi” është 100 pikë dhe vlerësimi "Shkëlqyeshëm".

Për sa i përket kriterit “Aftësia personale dhe angazhimi profesional”, konkretisht për treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent”, rezulton se aftësia e saj është shumë e lartë dhe propozohet pikëzimi me 25 pikë.

Edhe sa i përket treguesit “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”, nuk ka asnjë të dhënë për mosrespektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Për sa më sipër propozohet pikëzimi i saj me 15 pikë.

Sa i përket treguesit “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët” por edhe treguesit “Shkalla e komunikimit me administratën gjyqësore”, është pikëzuar për të dy këto tregues maksimalisht, duke vlerësuar se aftësia është shumë e lartë, duke qenë se nuk ka të dhëna që mund të afektojnë treguesit.

“Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, konkretisht “Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues”, rezulton se gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtarja ka qenë në cilësinë e lehtësueses në programin e formimit vazhdues në 1 aktivitet trajnues, gjithsej zhvilluar në dy ditë, si dhe në cilësinë e pjesëmarrëses në 15 ditë trajnimi. Referuar sa më sipër, vlerësoj se pjesëmarrja e gjyqtares në aktivitete është 15-120 ditë, duke e pikëzuar me 20 pikë. Megjithatë siç e kemi mbajtur qëndrimin edhe më parë, në kohën që i përket periudhës së vlerësimit nuk ka pasur përcaktim minimal për numrin e trajnimeve.

Sa i përket treguesit “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatë për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, siç relatuam më sipër, rezulton se gjyqtarja ka qenë pjesëmarrëse në cilësinë e lehtësueses në 1 aktivitet në Shkollën e Magjistraturës, të ndarë në dy ditë.

Për sa më sipër, për këtë tregues, vlerësoj se gjyqtarja duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Sa i përket “Angazhimit të gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale”, nuk rezultojnë të dhëna që gjyqtarja të jetë e angazhuar në këto veprimtari, për sa më sipër pikëzohet me 3 pikë, duke qenë se sipas rregullores në rast të mungesës së angazhimeve, pikëzimi fillon nga 3 pikë dhe në rast se ka angazhime, shtohen edhe 2 pikë të tjera.

Edhe për sa i përket treguesit “Publikime ligjore”, nuk rezulton që gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit të ketë publikime ligjore. Për këtë arsye, për këtë tregues, pikëzohet me 0 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit të kriterit “Aftësia personale dhe angazhimi profesional” është 93 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi është si më poshtë:

1. Aftësia profesionale e gjyqtarit, pikët 100 pikë.
2. Aftësia organizative, 100 pikë.
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, 100 pikë.
4. Aftësia personale dhe angazhimi profesional, 93 pikë.

Vlerësimi i përgjithshëm 393 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Irena Plaku: Për të shtuar që gjyqtarja është njoftuar rregullisht për projektraportin dhe nuk ka pasur kundërshtime, e konfirmuar nëpërmjet e-mailit të datës 14.10.2023 dhe nuk ka kërkuar as të marrë pjesë në procesin e vlerësimit.

Ilir Rusi: Faleminderit edhe për shtesën për njoftimin znj. Plaku.

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, të vazhdohet me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.10.2023)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektraportit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2017 – 2019 (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:31 dhe mbaroi në orën 14:39.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe nëpërmjet platformës*:

1. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)*
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim 1: Nuk merr pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.

2. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Vjollca Kola, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

3. Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).

5. Staf nga administrata e KLGJ-së.

6. BIRN, si dhe përfaqësues të tjerë nga mediat.

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektraportit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2017 – 2019 (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një tjetër pikë të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektraportit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2017 – 2019”, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës. Gjithashtu nëpërmjet postës elektronike zonja {...} është bërë me dije që vlersimi do të shqyrtohet në mbledhjen e ditës së sotme, për të cilin ka konfirmuar që ka marrë njoftim të kësaj date të zhvillimit të mbledhjes. Për më tej fjalën relatores znj. Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Gjyqtarja {...} është vlerësuar për periudhën trevjeçare të vlerësimit 2017-2019; është njoftuar për projektraportin; është njoftuar për raportin analitik dhe nuk ka paraqitur kundërshtime.

Ndërkohë, në pjesën e parë të projektraportit shpjegohet procedura e ndjekur nga ana e relatores që në momentin e fillimit të procedurës deri në momentin e plotësimit

të dosjes së vlerësimit dhe më pas hartimit të akteve, raportit analitik dhe raportit të vlerësimit.

Duke qenë që gjyqtarja nuk ka paraqitur kundërshtime, aktet ju janë vënë në dispozicion dhe jeni njohur me to, shkurtimisht po lexoj vetëm konkluzionet për secilin nga treguesit e katër kritereve të vlerësimit.

Lidhur me “Aftësitë profesionale të gjyqtares”, pikëzimi është 100 pikë duke marrë parasysh shumatoren e pikëzimit të të gjitha kritereve të këtij treguesi, pasi është vlerësuar se gjyqtarja spikat me aftësinë e saj në paraqitjen e fakteve, analizën e tyre, si të atyre me natyrë procedurale ashtu edhe atyre me natyrë materiale. Faktet paraqiten në mënyrë koncize, të plota dhe analitike, të integruara me provat e administruara dhe faktin e ekstraktuar prej tyre. Ka aftësi shumë të larta në identifikimin dhe interpretimin e normave konkrete procedurale ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes e cila më pas shërben si bazë edhe për analizën logjike të zgjidhjes së çështjes.

Dispozitat e ligjit material rezultojnë që janë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente duke i zbërthyer paraprakisht në elementë përbërës. Evidentohet kujdesi i gjyqtares për të identifikuar dhe zbatuar praktikën gjyqësore relevante, praktikën unifikuese njësuere si në aspektin procedural ashtu edhe në atë thelbësor.

I kushton rëndësi të posaçme arsytimit në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë, sidomos në pjesën e koncizitetit në pjesën përshkruese, duke i dhënë peshë më të madhe asaj arsytuese në vendim.

Struktura e vendimeve është e mirëorganizuar. Ka një metodologji të qartë, e cila i jep kuptueshmëri dhe rrjedhshmëri ecurisë së mendimit juridik.

“Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik”, shkallë shumë e lartë të aftësisë. Spikat aftësia e gjyqtares në interpretimin individual të ligjit. Mendimi logjik ka vijueshmëri. Mbështetet në praktikën gjyqësore dhe në interpretimin e ligjit dhe parimeve të përgjithshme të së drejtës. Arsyetimi është i qartë, është gjithëpërfshirës si dhe i jep përgjigje çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor në mënyrë të argumentuar.

Në mënyrë sintetike parashtrova konkluzionet e pjesës së parë që lidhen me “Aftësitë profesionale të gjyqtares”, për të cilën propozohet pikëzimi me 100 pikë.

Për sa i përket “Aftësive organizative”, 9.36% çështjet e përfunduara tej afatit ligjor – 15 pikë.

Standardet minimale të afatit kanë rezultuar, pas analizës logjike dhe matematikore se rreth 15% e tyre janë jashtë standardit minimal por referuar ngarkesës së gjyqtares, treguesit sasior të punës së saj kam propozuar rritjen me një shkallë. Pikëzimi me 5 pikë.

Për sa i përket “Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje” edhe për këtë tregues është propozuar pikëzimi me 5 pikë pasi ka tejkalim të standardit vetëm për një nga kategoritë e çështjeve, me 22 ditë, i cili është një tejkalim i papërfillshëm.

Për sa i përket “Rendimentit të përfundimit të çështjeve”, 104 %, pikëzimi me 10 pikë.

“Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar” - “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”. Shpjegohet hollësisht në projektraport e gjithë analiza që është bërë mbi dosjes e përzgjedhura me short. Pikëzimi 15 pikë.

“Numri mesatar i seancave” – 3.6 seanca dhe përgjithësisht gjyqtarja merr masa për shmangien e të gjitha seancave joproductive, dukshëm rezulton edhe nga numri i seancave (0.6 i tejkaluar), ndërkohë që mund të themi për këtë gjyqtare janë marrë në analizë 21 dosje të plota gjyqësore.

Për sa i përket “Kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, rezulton se gjyqtarja kryen me efikasitet të gjitha veprimet procedurale në të gjitha fazat e gjykimit (si civil edhe atë penal), duke respektuar zhvillimin e gjykimit në kohë dhe të drejtat e palëve ndërgjyqëse. Pikëzimi me 20 pikë.

Rregullshmëria dhe saktësia, pikëzimi me 5 dhe 10 pikë, pasi vlerësohet aftësia e gjyqtares në shkallën shumë të lartë. Dosjet janë lehtësisht të shfrytëzueshme, janë lehtësisht të aksesueshme, aktet janë të renditura në mënyrë të rregullt, dokumentacioni i dosjeve është i plotë dhe nuk rezultojnë dokumentata që nuk i përkasin dosjeve konkrete.

Për këtë arsye, për kriterin e dytë të “Aftësive organizative” propozohet pikëzimi me 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Për sa i përket të gjithë treguesve të kriterit të tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, nuk ka pasur të dhëna që mund të afektonin negativisht ndonjë nga këta tregues. Janë analizuar tek etika në punë të gjitha ankesat që janë trajtuar nga ILD-ja dhe në fakt kjo ka qenë edhe arsyeja që është zgjidhur në kohë procesi i vlerësimit të gjyqtarës, për shkak se ka pasur disa ankesa që kanë qenë në proces shqyrtimi nga ILD-ja. Ankesat janë të gjitha të arkivuara dhe asnjë prej tyre nuk referon për t’u marrë parasysh në vlerësimin etik dhe profesional sepse janë çështje që zgjidhen nëpërmjet ankimimit të vendimit gjyqësor.

Sa i përket “Integritetit”, kemi të njëjtin burim të dhënash. Kemi burim shtesë këtu edhe Raportin e ILDKPKI-së, në të cilin është konstatuar që nga ana e gjyqtarës nuk ka raste të konfliktit të interesit dhe se deklarimi i interesave private të saj kanë qenë të plota dhe të sakta.

Nuk është konstatuar përdorimi i gjuhës diskriminuese. Nuk ka pasur numër të lartë të kërkesave për përjashtim gjatë gjithë periudhës 3-vjeçare.

Për këtë arsye është propozuar për kriterin e tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” pikëzimi me 100 pikë dhe niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Gjyqtarja ka aftësi shumë të larta të komunikimit me kolegët dhe bashkëpunimit me stafin në gjykatë por edhe me stafin administrativ. Gjithashtu ka shkallë shumë të lartë të angazhimit të saj në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Për të gjithë periudhën 3-vjeçare ajo ka marrë pjesë në 42 trajnime, të shtrira në 60.5 ditë trajnimi, brenda kufijve 15-120 ditë.

Nuk ka pasur të dhëna për angazhimin e saj në mentorim apo në veprimtari ndërinstucionale, për këtë arsye është pikëzuar me 3 pikë në këta dy tregues.

Nuk ka pasur të dhëna për publikime ligjore akademike.

Përfundimisht për katër kriteret e vlerësimit propozimi është:

Për kriterin e parë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për kriterin e dytë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për kriterin e tretë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për kriterin e katërt “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 91.

Në total propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 391.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj dhe komplimente për paraqitjen sintetike të këtij projektvlerësimi. Njëkohësisht, ftoj anëtarët nëse kanë diskutime apo jo.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, të vazhdohet me votimin.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017 – 2019”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, të gjyqtares {...}, për periudhën 2017-2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Më tej mbledhja e ditës do të vazhdojë me një çështje tjetër e cila për shkak të natyrës së saj duhet të shqyrtohet me dyer të mbyllura, kështu që mbledhja në komunikim me publikun ndërpritet në këtë moment dhe ndërkohë do vazhdohet me shqyrtimin e çështjes që është me dyer të mbyllura.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor